

MBËSHTETJA E SHBA PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2013 NË SHQIPËRI

“Teksa shqiptarët përgatiten për ta nisur këtë kapitull të ri, një element ndryshimi duket sikur del mbi të gjithë të tjerët për nga rëndësia: mënyra se si zhvillohen zgjedhjet në Shqipëri, veçanërisht nevoja për ta zhvendosur vëmendjen tek njerëzit, ku institucionet qeveritare dhe partitë politike iu shërbejnë interesave të njerëzve.”— Ambasadori Amerikan në Shqipëri, Alexander A. Arvizu

Monitorimi i Periudhës Parazgjedhore

Për të vlerësuar se si Shqipëria po përgatitet për zgjedhjet e qershorit, Seksioni Politik dhe Ekonomik i Ambasadës po dërgon zyrtarët e tij në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Gjatë këtyre udhëtimeve, ata takohen me zyrtarë të pushtetit vendor, me përfaqësues të partive politike, dhe me grupe të tjera, për të parë nga afër përgatitjet e zgjedhjeve. Ata gjithashtu takohen edhe me drejtues politikë në rang kombëtar nga të gjitha partitë politike kryesore si dhe nga disa prej partive më të vogla për të shkëmbyer opinione në lidhje me zgjedhjet e ardhshme.

Debatet Parazgjedhore



Ambasada e SHBA-së po organizon një seri debatesh

parazgjedhore të cilat do të transmetohen nga rrjetet televizive shqiptare përpara qershorit 2013. Qëllimi është të bëjë pjesë të procesit zgjedhor, për herë të parë, debatet politike tematike, të nxitë partitë politike që të fokusohen në tema në fushatat e tyre dhe të angazhojë qytetarët në diskutime politikash mbi çështje që kanë të bëjnë me të ardhmen e Shqipërisë. Pjesëmarrësit në debat janë nga forumet rinore të pesë partive politike. Ky do të jetë i pari debat i një modeli ndërkombëtar që transmetohet në televizionet shqiptare.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

USAID po ofron asistencë teknike për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri në dy drejtime kryesore: 1) Planifikim dhe përgatitje për zgjedhjet, që përfshin një vlerësim të integritetit zgjedhor, ndihmën për planet operacionale dhe të departamenteve të këtij Komisioni, punën për një strategji të angazhimit qytetar, dhe përgatitje dhe trajnim në IT; dhe 2) Planifikim dhe vlerësim paszgjedhor, që përfshin punën për të vlerësuar efektivitetin e teknologjive pilot dhe një vlerësim të zbatimit të detyrave në lidhje me zgjedhjet, në të gjitha nivelet përkatëse. Dy objektivat e mëdha të këtij programi duhet të sigurojnë një asistencë teknike të standardeve ndërkombëtare për KQZ-në, në mënyrë që të kemi impakt pozitiv në zgjedhjet e qershorit 2013, dhe që të “nxjerrim mësim” për të punuar për institucione më të fuqishme zgjedhore në të ardhmen.

Monitorimi Vendor i Zgjedhjeve

USAID po sponsorizon një projekt për monitorimet, zbatuar nga OJQ

-ja Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, i cili do të monitorojë të

gjithë procesin zgjedhor, duke përfshirë periudhën para zgjedhjeve, periudhën gjatë votimit, dhe periudhën gjatë numërimit të votave. Koalicioni do të punësojë, do të trajnojë, dhe do të shpërndajë, mjaft dukshëm, vëzhgues të pavarur vendorë në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Gjithashtu, Koalicioni do të ofrojë përditësime të rregullta për publikun dhe për medianë në lidhje me përgatitjet për zgjedhje, dhe përditësime sa më afër kohës reale gjatë ditës së zgjedhjeve dhe gjatë procesit të numërimit të votave.



Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë 2013

Mbështetja e SHBA-së për zgjedhjet 2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Monitorimi Vendor i Zgjedhjeve

Debatet parazgjedhore

Mbështetja për shoqërinë civile

Monitorimi i periudhës parazgjedhore

Partneriteti i donatorëve

Vëzhgimi ndërkombëtar dhe Forcimi i Monitorimit Vendor

SHBA, përmes mbështetjes së USAID-it për Institutin Demokratik Amerikan, do të ofrojë asistencë për kryerjen e vëzhgimit ndërkombëtar dhe për të integruar më mirë punën e vëzhguesve ndërkombëtarë me vëzhguesit vendorë. Përveç kësaj, ekspertë teknikë ndërkombëtarë do të këshillojnë organizata vendore të shoqërisë civile me praktikatat më të mira të monitorimit.



Mbështetja për shoqërinë civile

Shoqëria civile shqiptare ka një rol jetik në sigurimin e integritetit të zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit 2013. Për këtë arsye Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA-ve po mbështet

përpjekjet e shoqërisë civile që adresojnë aspektet më të rëndësishme të procesit zgjedhor në Shqipëri, të tilla si: nisma të ndërgjegjësimit për rëndësinë e të votuarit; e drejta e votës dhe mundësia për të votuar për personat me aftësi të kufizuara, për komunitetin rom, për LGBT-të, dhe për grupe të tjera të pafavorizuara ose për pakicat; pjesëmarrja e grave si votuese dhe si kandidatë; të rinjtë votues dhe ata që votojnë për herë të parë; forumet qytetare; fushatat e mediave sociale, etj.

Përfutuesit e Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci:

- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Shoqata Kristiane e Grave të Shqipërisë
- Aleanca kundër Diskriminimit të LGBT-ve dhe Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT (Pro LGBT)
- Qendra EDEN
- Gruaja në Zhvillim
- Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri
- Instituti për Mirqënie e Ambjent
- Qendra SFIDA
- Balkan Youth Link – Albania (BYL-A)
- Shoqata për integrimin e Zonave Informale dhe Lëvizja Mjaft!
- Qendra Rinore e Vlorës
- Instituti Shqiptar i Çështjeve Publike

Partneriteti i Donatorëve

Shtetet e Bashkuara, firmëtare e Deklaratës së Parisit dhe e Marrëveshjes së Busanit (që pason Deklaratën e Parisit), është e angazhuar për të punuar në krah të partnerëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë për të siguruar zgjedhje të lira, të ndershme dhe transparente. Që nga mbështetja për KQZ-në e sponsorizimi i debateve, dhe deri te monitorimi ndërkombëtar dhe vendor, Shtetet e Bashkuara i kanë hartuar dhe i kanë nisur këto programe pas një konsultimi të detajuar me partnerët shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet e rregullta të harmonizimit të donatorëve që fokusohen në ‘asistencën për zgjedhjet’, Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të kërkojnë orientime nga këta partnerë, ndërkohë që veprimtaritë kalojnë nga faza e hartimit të ajo e zbatimit. Përveç kësaj, Ambasada e SHBA-së në Tiranë do të verë në dispozicion staf amerikan dhe shqiptar për të ndihmuar misionin e OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve.